



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 81

4 maj

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 108, datë 16.3.2000	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për bashkëpunimin në fushën e turizmit.....	1
Vendim i KM nr. 120, datë 18.3.2000	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	1
Vendim i KM nr. 137, datë 23.3.2000	Për një shtesë në buxhetin e vitit 2000, miratuar për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.....	2
Vendim i KM nr. 192, datë 21.4.2000	Për miratimin e marrëveshjes “Programi i bashkëpunimit financiar, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Spanjës”.....	2
Vendim i KM nr. 347, datë 7.7.2000	Për lirim dhe emërim në detyrë të Sekretarit të Këshillit të rrethit Berat.....	3
Vendim i KM nr. 369, datë 14.7.2000	Për miratimin e protokollit të bashkëpunimit, në fushën e navigimit ajror, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Qeverisë së ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (FYROM) dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë.....	3
Vendim i KM nr. 104, datë 20.2.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe rrjetit rural të Republikës së Shqipërisë”..	4
Vendim i KM nr. 137, datë 7.3.2003	Për miratimin e letres së politikave të zhvillimit për fazën e dytë të kredisë, në mbështetje të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik dhe Social (SKZHES).....	5

Vendim i KM nr. 152, datë 13.3.2003	Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “ROT”, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë e Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës nga njëra anë dhe shoqërisë “Emikel” sh.p.k., për hidrocentralet vendore, Lenie, Çorovodë, Tuçep...	5
Vendim i KM nr. 250, datë 24.4.2003	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik.....	6
Vendim i KM nr. 251, datë 24.4.2003	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemeve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve, të ndërmarrjeve në Bulqizë, Fushë-Arrëz, Gramsh, Krastë, Kuçovë, Malësi e Madhe, Mirditë, Peshkopi, Përmet, Poliçan, Pukë, Rrogozhinë, Skrapar, Shkodër, Vau i Dejës dhe Vlorë.....	6
Vendim i KM nr. 510, datë 18.7.2003	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve.....	8
Vendim i KM nr. 515, datë 18.7.2003	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes.....	14
Vendim i KM nr. 112, datë 27.2.2004	Për disa ndryshime në vendimin nr. 155, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave “Për funksionimin, të drejtat dhe detyrat e Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve”.....	15
Vendim i KM nr. 509, datë 13.5.2009	Për një ndryshim në vendimin nr. 857, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor, nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar.....	16

VENDIM
Nr. 108, datë 16.3.2000

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E TURIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për bashkëpunimin në fushën e turizmit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 120, datë 18.3.2000

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 39 të ligjit nr. 7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” dhe të pikës 9 të nenit 5 të ligjit nr. 7608, datë 22.9.1992, ndryshuar me ligjin nr. 8209, datë 22.4.1997 “Për prefekturat”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z.Fadil Osmani lirohet nga detyra e sekretarit të këshillit të komunës Llugaj, rrethi Tropojë.
 2. Z.Nikoll Pepkolaj emërohet sekretar i këshillit të komunës Llugaj, rrethi Tropojë.
 3. Z.Murat Jançe lirohet nga detyra e sekretarit të këshillit të komunës Gjergjan, rrethi Elbasan.
 4. Z.Bashkim Hysa emërohet sekretar i këshillit të komunës Gjergjan, rrethi Elbasan.
 5. Z.Bashkim Alimeta lirohet nga detyra e sekretarit të këshillit të komunës Selitë, rrethi Mallakastër.
 6. Z.Nezir Jaupi emërohet sekretar i këshillit të komunës Selitë, rrethi Mallakastër.
 7. Z.Fejzi Buzalli lirohet nga detyra e sekretarit të këshillit të komunës Barbullush, rrethi Shkodër.
 8. Z.Fatmir Lankollari emërohet sekretar i këshillit të komunës Barbullush, rrethi Shkodër.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta



VENDIM
Nr. 137, datë 23.3.2000

**PËR NJË SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2000, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8554, datë 10.12.1999 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2000”, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2000, miratuar për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, shtohet shuma 5 400 000 (pesë milionë e katërqind mijë) lekë, për të shlyer detyrimet ndaj Telekomit.
 2. Shpenzimet do të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 192, datë 21.4.2000

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES “PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT FINANCIAR,
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
SPANJËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes “Programi i bashkëpunimit financiar, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Spanjës”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 347, datë 7.7.2000

**PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË TË SEKRETARIT TË KËSHILLIT TË
RRETHIT BERAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 54 të ligjit nr. 7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” dhe të nenit 5 pika 9 të ligjit nr. 7608, datë 22.9.1992 “Për prefekturat”, ndryshuar me ligjin nr. 8209, datë 22.4.1997, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z.Zylyftar Çela lirohet nga detyra e sekretarit të këshillit të rrethit, Berat.
 2. Z.Vullnet Zylyftari emërohet sekretar i këshillit të rrethit, Berat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 369, datë 14.7.2000

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË BASHKËPUNIMIT, NË FUSHËN E NAVIGIMIT
AJROR, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QEVERISË SË ISH-
REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË (FYROM) DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË GREQISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të bashkëpunimit, në fushën e navigimit ajror, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Qeverisë së ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (FYROM) dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta



VENDIM
Nr. 104, datë 20.2.2003

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 405, DATË 8.1.1996 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR
KOMBËTAR DHE RRJETIT RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 124 e 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 74 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “...i Republikës së Shqipërisë...” shifra “...prej 7350 km...”, hiqet.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Rrugët rurale të kategorizohen në rrugë rurale komunale dhe rrugë rurale rajonale.

a) Rrugë rurale komunale janë ato që lidhin:

- qendrat e komunave me fshatrat dhe qendrat e banuara apo rrugët lidhëse ndërmjet fshatrave që kanë nën juridiksion.

b) Rrugë rurale rajonale janë ato që lidhin:

- qendrat e komunave me qendrat e rrethit ose rrjetin rrugor kombëtar;

- rrugë ndërmjet dy a më shumë komunave;

- rrugë të rëndësishme të veçantë, si rrugët që lidhin qendrat e komunës ose fshatrat me qendrat muzeale, arkeologjike apo zona të tjera turistike.”.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Inventari i rrugëve rurale t’i kalojë në administrim njësisive përkatëse të pushtetit vendor, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

4. Pas pikës 6 shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

“7. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, këshillat e qarqeve dhe këshillat e komunave për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 137, datë 7.3.2003

**PËR MIRATIMIN E LETRËS SË POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT PËR FAZËN E DYTË
TË KREDISË, NË MBËSHTETJE TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË ZHVILLIMIT
EKONOMIK DHE SOCIAL (SKZHES)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letrës së politikave të zhvillimit për fazën e dytë të kredisë, në mbështetje të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik dhe Social (SKZHES).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 152, datë 13.3.2003

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT TË FORMËS “ROT”,
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË E MINISTRISË SË INDUSTRIJË DHE TË
ENERGJETIKËS NGA NJËRA ANË DHE SHOQËRISË “EMIKEL” SHPK, PËR
HIDROCENTRALET VENDORE, LENIE, ÇOROVODË, TUÇEP**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7 e 9 të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe në infrastrukturë” dhe të nenit 2 të ligjit nr. 8527, datë 23.9.1999 “Për privatizimin e hidrocentraleve vendore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “ROT”, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë e Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës nga njëra anë, dhe shoqërisë “Emikel” sh.p.k., për hidrocentralet vendore, Lenie, Çorovodë, Tuçep, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano



VENDIM
Nr. 250, datë 24.4.2003

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË RENDIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 3 dhe 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik.
2. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 251, datë 24.4.2003

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE TË SISTEMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË KANALIZIMEVE, TË
NDËRMARRJEVE NË BULQIZË, FUSHË-ARRËZ, GRAMSH, KRASTË, KUÇOVË,
MALËSI E MADHE, MIRDITË, PESHKOPI, PËRMET, POLIÇAN, PUKË,
RROGOZHINË, SKRAPAR, SHKODËR, VAU I DEJËS DHE VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 dhe 8, pika 3 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, si më poshtë vijon:
 - a) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm, që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Bulqizë, sipas listës 1 të përbërë nga 10 (dhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - b) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve që administrohet nga sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime, Fushë-Arrëz, sipas listës 2 të përbërë nga 2 (dy) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - c) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm, që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Gramsh, sipas listës 3 të përbërë nga 14 (katëmbëdhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - ç) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve që administrohet nga ndërmarrja e Ujësjiellës-Kanalizimeve, Krastë, sipas listës 4 të përbërë nga 4 (katër) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

d) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve që administrohet nga sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime, Kuçovë, sipas listës 5 të përbërë nga 10 (dhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

dh) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Malësi e Madhe, sipas listës 6 të përbërë nga 12 (dymbëdhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

e) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Mirditë, sipas listës 7 të përbërë nga 3 (tri) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

ë) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Peshkopi, sipas listës 8 të përbërë nga 10 (dhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

f) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Përmet, sipas listës 9 të përbërë nga 10 (dhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

g) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Poliçan, sipas listës 10 të përbërë nga 3 (tri) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

gj) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime, Pukë, sipas listës 1 të përbërë nga 24 (njëzet e katër) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

h) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve që administrohet nga sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime, Rrogozhinë, sipas listës 12 të përbërë nga 4 (katër) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

i) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Skrapar, sipas listës 13 të përbërë nga 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

j)) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve që administrohet nga sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime, Shkodër, sipas listës 14 të përbërë nga 7 (shtatë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

k) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga Ndërmarrja e Ujësjiellësit, Vau i Dejës, sipas listës 15 të përbërë nga 2 (dy) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

l) Për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm që administrohet nga sh.a. Ujësjiellësi, Vlorë, sipas listës 16, të përbërë nga 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave për t'u transferuar në njësitë e qeverisjes vendore, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano



VENDIM
Nr. 510, datë 18.7.2003

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
MBRETËRISË SË SPANJËS, PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË
INVESTIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS
PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË INVESTIMEVE

Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Spanjës, këtu më poshtë të referuara si “Palë”,
duke dëshiruar të intensifikojnë bashkëpunimin ekonomik ndërmjet të dy vendeve;
duke synuar të krijojnë kushte të favorshme për investimet e bëra nga investitorët e secilës palë në territorin e palës tjetër; dhe
duke njohur se nxitja dhe mbrojtja e investimeve në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të stimulojë iniciativat në këtë fushë,
ranë dakord si vijon:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

1. Termi “investitor” nënkupton çdo shtetas apo shoqëri të çdo pale që bën investime në territorin e palës tjetër;

a) Termi “shtetas” nënkupton personin fizik, i cili në përputhje me legjislacionin e palës, konsiderohet si shtetas i saj.

b) Termi “kompani” nënkupton personat juridikë ose çdo ent tjetër juridik, duke përfshirë shoqëritë e përbashkëta, korporatat apo shoqatat e biznesit, të organizuara në përputhje me legjislacionin e palës.

2. Termi “investim” nënkupton çdo lloj pasurie të investuar nga investitorë të një pale në territorin e palës tjetër, në përputhje me ligjet dhe rregullat e kësaj të fundit dhe në veçanti, por jo ekskluzivisht, si më poshtë:

- a) Pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo të drejtë tjetër pasurore, si: hipotekat, barrat, pengjet dhe të drejta të tjera të ngjashme;
- b) Një kompani apo ndërmarrje biznesi, pjesëmarrjen me aksione, detyrimet e një shoqërie dhe çdo formë tjetër e pjesëmarrjes në një shoqëri apo ndërmarrje biznesi;
- c) E drejta për kontribut monetar apo të çdo lloj forme tjetër kontributi, në cilësinë e një kontrate që mbart vlerë ekonomike dhe të jetë e lidhur me një investim;
- d) Te drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale, si: proceset teknike, *know-how* dhe dëshira e mirë;
- e) Të drejtat për të ndërmarrë veprimtari ekonomike dhe tregtare në bazë të ligjit ose në sajë të një kontrate, duke përfshirë koncesionet për kërkimin, realizimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore.

Investimet e bëra në territorin e një pale, nga çdo kompani e kësaj pale, e cila është aktualisht në pronësi apo kontrollohet efektivisht prej investitorëve të palës tjetër, do të konsiderohen gjithashtu si investimet e investitorëve të kësaj të fundit, nëse këto investime janë bërë në përputhje me ligjet dhe rregullat e palës, në territorin e së cilës janë bërë investimet.

Çdo ndryshim në formën në të cilën pasuritë janë investuar ose riinvestuar nuk do të prekin karakterin e tyre si investim.

3. Termi “të ardhura” kupton shumat e vjela nga një investim dhe përfshin në veçanti, por jo ekskluzivisht, fitimin, dividendët, interesat, rritjen e kapitalit, shpërblimet dhe të ardhura në forma të tjera.

4. Termi “territor” përcakton tërësinë tokësore, ujërat e brendshme dhe territorin detar dhe hapësirën ajrore të secilës palë, si dhe zonën ekonomike ekskluzive dhe shelfin kontinental jashtë kufijve të ujërave, territorialë të secilës palë, mbi të cilat ato ushtrojnë ose mund të ushtrojnë të drejtat e sovranitetit dhe juridiksionit në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

Neni 2

Nxitja dhe pranimi i investimeve

1. Çdo palë do të nxisë në territorin e saj, sa më shpejt të jetë e mundur, investimet e investitorëve të palës tjetër. Çdo palë do t’i pranojë këto investime në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e saj.

2. Kur një palë ka pranuar një investim në territorin e saj, ajo do t’i japë, në përputhje me ligjet dhe rregullat e saj, lejet e nevojshme që janë të lidhura me këtë investim dhe kryerjen e marrëveshjeve të licencimit dhe kontratave për asistencë teknike, tregtare apo administrative. Çdo palë do të bëjë përpjekje të lëshojë autorizimet e nevojshme në lidhje me aktivitetin e konsultimit dhe për persona të tjerë të kualifikuar, pavarësisht nga kombësia e tyre.

Neni 3

Mbrojtja

1. Investimeve të bëra nga investitorët e njërës palë në territorin e palës tjetër do t’u jepet një trajtim i drejtë dhe i barabartë dhe do të gëzojnë mbrojtje dhe siguri të plotë. Në asnjë rast një palë nuk do t’u japë këtyre investimeve trajtim më pak të favorshëm sesa ai i kërkuar nga e drejta ndërkombëtare.

2. Asnjëra palë nuk do të pengojë në asnjë mënyrë, nëpërmjet masash arbitrare ose diskriminuese, operimin, menaxhimin, mirëmbajtjen, përdorimin, gëzimin, tjetërsimin e këtyre investimeve. Çdo palë do të kujdeset për përmbushjen e çdo detyrimi të shkruar, që ka të bëjë me investimet e investitorëve të palës tjetër.



Neni 4

Trajtimi kombëtar dhe i kombit më të favorizuar

1. Çdo palë do t'u japë në territorin e saj, investimeve të investitorëve të palës tjetër, një trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai që ajo i ka dhënë investimeve të investitorëve të një shteti të tretë, si të jetë më e favorshme për investitorin në fjalë.

2. Çdo palë në territorin e saj do t'u sigurojë investitorëve të palës tjetër, për sa i përket menaxhimit, mirëmbajtjes, përdorimit, gëzimit, apo tjetërsimit të investimeve të tyre, një trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai i dhënë investitorëve të vendit të saj, apo atyre të një shteti të tretë, si të jetë më e favorshme për investitorin në fjalë.

3. Trajtimi i dhënë sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk do të konsiderohet si detyrim për një palë, që të shtrijë tek investitorët e palës tjetër dhe investimet e tyre, përfitimet prej çdo trajtimi, preference apo privilegji, që rezulton nga:

a) anëtarësimi apo përfshirja e tij në të ardhmen në një zonë të tregtisë së lirë, bashkimi doganor, bashkimi ekonomik apo monetar ose në marrëveshje të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë forma të tjera të organizimit ekonomik rajonal të ardhshme ose ekzistuese; ose

b) çdo marrëveshje apo rregullim ndërkombëtar ose çdo ligj i brendshëm që ka të bëjë tërësisht ose kryesisht me taksimin.

4. Masat që duhen marrë për arsye sigurie dhe rendi publik apo shëndeti publik, në kontekstin e këtij neni, nuk do të konsiderohen si "më pak favorizuese".

Neni 5

Shpronësimi

1. Investimet e investitorëve të secilës palë në territorin e palës tjetër nuk do të shpronësohen, shtetëzohen ose nuk do të jenë subjekt i ndonjë mase tjetër që ka efekt ekuivalent me atë të shpronësimit apo të shtetëzimit (këtu më poshtë referuar si "shpronësim"), me përjashtim kur kërkohet për interes publik, mbështetur në ligj, mbi baza jodiskriminuese dhe me anë të pagesës së menjëhershme, të përshtatshme dhe një kompensimi efektiv.

2. Ky kompensim do të llogaritet sipas vlerës reale të tregut të investimit të shpronësuar, në momentin përpara se shpronësimi të kryhet ose përpara se ky shpronësim të bëhet publikisht i njohur, cilido është më i hershmi (këtu më poshtë referuar si "datë vlerësimi").

3. Kjo vlerë tregu do të shprehet në një monedhë lirisht të konvertueshme me kursin e këmbimit që mbizotëron në treg dhe do të ketë garanci deri në datën e vlerësimit. Kompensimi do të përfshijë interesin e zakonshëm tregtar të përcaktuar sipas kritereve të tregut për monedhën e vlerësimit, prej datës së shpronësimit deri në datën e pagesës. Kompensimi do të paguhet pa vonesë dhe do të jetë efektivisht i realizueshëm e lirisht i transferueshëm.

4. Investitori i prekur gëzon të drejtën, sipas ligjit të palës që bën shpronësimin, për një shqyrtim të menjëhershëm nga ana e autoriteteve gjyqësore apo kompetente të kësaj pale, të rastit të tij, duke përfshirë vlerën e investimit të tij dhe pagesën e kompensimit në përputhje me parimet e vendosura në këtë nen.

5. Kur një palë shpronëson pasuritë e një shoqërie, e cila është krijuar apo themeluar sipas legjislacionit në fuqi në çdo pjesë të territorit të saj, dhe në të cilën investitorët e palës tjetër zotërojnë aksione, ajo do të sigurojë që dispozitat e këtij neni të zbatohen si garanci për një kompensim të menjëhershëm, të përshtatshëm dhe efektiv në lidhje me investimin e tyre, ku investitorët e palës tjetër janë zotërues të këtyre aksioneve.

Neni 6

Kompensimi për humbjet

1. Investitorët e një pale, investimet e të cilëve pësojnë humbje në territorin e palës tjetër për shkak të konfliktit të armatosur, revolucionit, gjendjes së emergjencës kombëtare, kryengritjeve, luftës civile ose ngjarjeve të ngjashme, do t'u jepet nga kjo palë në lidhje me kthimin, zhdëmtimin, kompensimin ose ndonjë zgjidhje tjetër të vlefshme, një trajtim jo më pak i favorshëm sesa kjo palë u jep investitorëve të vet ose të një shteti të tretë, cilido qoftë më i favorshmi prej tyre për investitorin. Pagesat e rezultuara do të jenë lirisht të transferueshme.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, një investitori të një pale, i cili, në secilën nga situatat e referuara në këtë paragraf pëson humbje në territorin e palës tjetër që rezulton nga:

- a) rekuizimi i investimit apo i një pjese të tij nga forcat apo autoritetet e kësaj të fundit;
- b) shkatërrimi i investimit ose i një pjese të tij, nga forcat apo autoritetet e kësaj të fundit, që nuk ishte i nevojshëm për situatën, do t'i jepet nga pala e fundit dëmshpërblimi apo kompensimi, i cili në çdo rast do të jetë i menjëhershëm, i përshtatshëm dhe efektiv. Pagesat që rrjedhin prej saj do të bëhen pa vonesë dhe do të jenë lirisht të transferueshme.

Neni 7

Transferimet

1. Çdo palë do t'u garantojë investitorëve të palës tjetër transferimin e lirë të të gjitha pagesave që kanë të bëjnë me investimet e tyre. Këto transferime do të përfshijnë në veçanti, por jo ekskluzivisht:

- a) Kapitalin fillestar dhe çdo shtesë në kapital për mirëmbajtjen apo rritjen e një investimi;
- b) Të ardhurat nga investimi, të përcaktuara si në nenin 1;
- c) Fondet për shlyerjen e huave në lidhje me një investim;
- d) Kompensimet të parashikuara në nenet 5 dhe 6;
- e) Të ardhurat nga shitja apo likuidimi i pjesshëm ose i plotë i një investimi;
- f) Të ardhurat dhe shpërblimet e personelit të angazhuar nga jashtë në lidhje me një investim;
- g) Pagesat që rrjedhin nga zgjidhja e një mosmarrëveshjeje.

2. Transferimet sipas kësaj marrëveshjeje do të kryhen pa vonesë dhe në një monedhë lirisht të konvertueshme me kursin e këmbimit që aplikohet në datën e transferimit.

Neni 8

Aplikimi i dispozitave të tjera

1. Nëse legjislacioni i ndonjërës prej palëve ose detyrimet që rrjedhin sipas së drejtës ndërkombëtare ekzistuese, apo të vendosur më vonë midis palëve si plotësim i kësaj Marrëveshjeje, përmbajnë norma, qofshin këto të përgjithshme apo të veçanta, që u japin investitorëve të palës tjetër një trajtim më të favorshëm sesa i dhënë nga kjo Marrëveshje, këto norma do të jenë mbizotëruese për aq sa ato janë më të favorshme kundrejt kësaj Marrëveshjeje.

2. Kushtet më favorizuese sesa ato të kësaj Marrëveshjeje për të cilat është rënë dakord nga njëra prej palëve me investitorët e palës tjetër, nuk do të preken nga kjo Marrëveshjeje.

3. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të cenojë efektin e dispozitave të krijuara nga marrëveshjet ndërkombëtare, lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale që janë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.



Neni 9

Zëvendësimi me të drejta të plota

Nëse një palë ose agjencia e përcaktuar prej saj bën një pagesë për një zhdëmtim, garanci apo kontratë sigurimi kundrejt një risku jotregtar në lidhje me një investimin të bërë nga ndonjë prej investitorëve në territorin e palës tjetër, pala e fundit do të njohë kalimin e çdo të drejte apo detyrimi të këtij investitori tek ish-pala apo agjencia e përcaktuar prej saj, që të ushtrojë në bazë të zëvendësimit me të drejta të plota, çdo të drejtë në të njëjtën masë sa edhe paraardhësi i tij. Ky zëvendësim me të drejta të plota do të bëjë të mundur që ish-pala apo agjencia e përcaktuar prej saj të jetë direkt përfituese e çdo pagese për dëmshpërblim apo kompensim tjetër që mund të ketë të drejtë investitori.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis palëve

1. Çdo mosmarrëveshje midis palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, për sa është e mundur, do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Në qoftë se mosmarrëveshja nuk është e mundur të zgjidhet brenda gjashtë muajve prej fillimit të bisedimeve, ajo do t'i nënshtrohet, me kërkesën e njërës prej palëve, një gjykate arbitrazhi.

3. Gjykata e arbitrazhit do të krijohet në mënyrën e mëposhtme. Çdo palë do të emërojë një gjykatës dhe këta dy gjykatës do të zgjedhin shtetasin e një shteti të tretë si kryetar të saj. Gjykatësit do të zgjidhen brenda tre muajve dhe kryetari brenda pesë muajve nga data kur secila palë njofton palën tjetër për vendimin e saj, që t'ia nënshtrojë mosmarrëveshjen një gjykate arbitrazhi.

4. Në rast se brenda afateve të specifikuara në paragrafin 3 të këtij neni nuk janë bërë emërimet e nevojshme, secila palë, në mungesë të ndonjë marrëveshjeje tjetër, mund të ftojë Presidentin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të bëjë emërimet e nevojshme. Në rast se Presidenti është shtetas i ndonjëres prej palëve, ose në qoftë se ai e ka të ndaluar të kryejë funksionet e mësipërme, Zëvendës-presidenti ftohet që të bëjë emërimet e nevojshme. Në rast se Zëvendës-presidenti është gjithashtu shtetas i njërës prej palëve ose nëse ai e ka të ndaluar të kryejë funksionet e mësipërme, anëtari më i vjetër i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i cili nuk është shtetas i njërës prej palëve, do të ftohet të bëjë emërimet e nevojshme.

5. Gjykata do t'i nxjerrë vendimet e saj në bazë të dispozitave që përmban kjo Marrëveshje, si dhe të parimeve universale të së drejtës ndërkombëtare.

6. Gjykata i përcakton vetë procedurat, përveçse kur palët vendosin ndryshe.

7. Gjykata e arbitrazhit do t'i marrë vendimet me shumicë votash dhe ky vendim do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për të dyja palët.

8. Çdo palë do të përballojë shpenzimet për gjykatësin e zgjedhur prej saj dhe ato të përfaqësimit në procedurat e arbitrazhit. Shpenzimet e tjera, përfshirë dhe ato të kryetarit, do të përballohen në pjesë të barabarta nga të dyja palët.

Neni 11

Mosmarrëveshjet midis një pale dhe një investitori të palës tjetër

1. Mosmarrëveshjet midis një investitori të njërës palë dhe palës tjetër, në lidhje me një investim sipas kësaj Marrëveshjeje, do t'i paraqiten me shkrim nga investitori palës së dytë.

Brenda mundësive, palët e interesuara do të përpiqen t'i zgjidhin këto mosmarrëveshje në mënyrë miqësore nëpërmjet negociatave.

2. Në rast se këto mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhen miqësisht brenda gjashtë muajve nga data kur njoftimi me shkrim referuar paragrafit 1 është shtruar për zgjidhje, mosmarrëveshjet, sipas zgjedhjes së investitorit, do t'i nënshtrohen:

- Gjykatës kompetente të palës në territorin e së cilës është kryer investimi; ose
- Një gjykatë të përkohshme të krijuar sipas Rregullave të Arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Ligjin Tregtar Ndërkombëtar; ose
- Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve midis shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera, e hapur për nënshkrim në Washington D.C., më 18 mars 1965, në rastin kur të dyja palët janë anëtarë të kësaj konvente. Për sa kohë njëra palë, e cila është palë në mosmarrëveshje nuk është bërë shtet nënshkrues i konventës së përmendur më sipër, mosmarrëveshja do të trajtohet në përputhje me dispozitat shtesë për administrimin e procedurave të pajtimit, arbitrazhit dhe verifikimit të fakteve të ICSID.

3. Arbitrazhi do të bazohet në dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, legjislacionit kombëtar të palës në territorin e së cilës është bërë investimi, përfshirë rregullat që kanë të bëjnë me konfliktet e ligjeve, si dhe normat dhe parimet, përgjithësisht të pranuar, të së drejtës ndërkombëtare respektive.

4. Një palë nuk do të shfrytëzojë për mbrojtje faktin se është marrë nga investitori dëmshpërblim ose ndonjë kompensim tjetër për të gjithë ose një pjesë të dëmit në fjalë në bazë të një garancie ose kontrate sigurimi.

5. Vendimi do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët në mosmarrëveshje. Secila palë merr përsipër që të zbatojë vendimet në përputhje me legjislacionin e vendit të saj.

Neni 12

Fusha e aplikimit

1. Kjo marrëveshje do të jetë e aplikueshme për investimet e bëra, si para ashtu dhe pas hyrjes në fuqi, nga investitorët e secilës palë në territorin e palës tjetër.

Neni 13

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën palët do të njoftojnë njëra-tjetrën se formalitetet respektive kushtetuese të kërkuara për hyrjen në fuqi të Marrëveshjeve janë përmbushur.

2. Kjo marrëveshje do të jetë në fuqi për një periudhë fillestare dhjetëvjeçare. Në vazhdim ajo do të mbetet në fuqi përderisa nuk do të denoncohet me shkrim nga ndonjëra prej palëve dymbëdhjetë muaj përpara afatit të përfundimit. Pas përfundimit të periudhës fillestare dhjetëvjeçare kjo marrëveshje mund të denoncohet në çdo kohë nga çdo palë duke i dërguar një lajmërim me shkrim palës tjetër dymbëdhjetë muaj përpara.

3. Për investimet e bëra përpara datës së përfundimit të kësaj marrëveshjeje, dispozitat e neneve 1 deri 12 të kësaj marrëveshjeje do të mbeten në fuqi për një periudhë të mëtejshme dhjetëvjeçare nga data e përfundimit të kësaj marrëveshjeje.

Si dëshmi të kësaj, përfaqësuesit fuqplotë respektivë nënshkruajnë këtë Marrëveshje.

Bërë në Madrid, më 5 qershor 2003, në dy origjinale në gjuhët shqip, spanjisht dhe anglisht, duke qenë të gjitha tekstet me fuqi të barabartë. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje do të merret për bazë teksti në gjuhën angleze.



Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

ILIR META
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Jashtëm

Për Qeverinë e Mbretërisë së Spanjës

RAMÓN DE MIGUEL Y EGEA
Sekretar Shteti për Çështjet Europiane

VENDIM

Nr. 515, datë 18.7.2003

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës e të neneve 8 pika 3 dhe 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të pronave me numër rendor 9 dhe 10 (Klubi shumësportësh “Partizani”), 549 (Shtëpia e Ushtarakëve, Korçë) dhe 653 (Shtëpia e Ushtarakëve, Përmet), që me vendim të Këshillit të Ministrave, u kanë kaluar në administrim institucioneve të tjera.

Lista përfshin 1 117 (një mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) prona dhe përbëhet nga 765 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministria e Mbrojtjes dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM

Nr. 112, datë 27.2.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 155, DATË 25.4.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR FUNKSIONIMIN, TË DREJTAT DHE DETYRAT E ENTIT SHTETËROR TË FARËRAVE DHE FIDANËVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr. 8732, datë 24.1.2001 “Për materialin mbjellës bimor”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr. 155, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë vijon:

“b) Kryerjen dhe mbikëqyrjen e provave të testimit të varieteteve të reja të bimëve të kultivuara të krijuara në vend ose të ardhura nga vendet e tjera, për vlerën e kultivimit e të përdorimit (VKP) dhe për dallueshmërinë, uniformitetin e stabilitetin (DUS).

Provat zyrtare të testimit të varieteteve të bimëve të arave kryhen për:

- varietetet e krijuara në vend, në jo më pak se dy vjet;
- varietetet që përfshihen në regjistrin e OECD-së, në jo më pak se një vit, dhe, pas kualifikimit ato përfshihen në katalogun zyrtar;
- varietetet e regjistruara në vendet e tjera, por që nuk përfshihen në regjistrin e OECD-së, në jo më pak se një vit dhe vetëm për vlerën e kultivimit e të përdorimit (VKP);
- varietetet e bimëve drufrutore, në jo më pak se dy vjet pas hyrjes së tyre në prodhim.

Kryerja e provave zyrtare të testimit të varieteteve të bimëve të kultivuara realizohet, në jo më pak se dy zona që përfaqësojnë kushte të ndryshme klimatike.

Zonat ku do të kryhen provat zyrtare të testimit të varieteteve janë: Tirana, Shkodra, Dibra, Korça, Lushnjë dhe Vlora.”.

b) Shkronja “e” ndryshohet si më poshtë vijon:

“e) Botimin e katalogut zyrtar të specieve dhe varieteteve të bimëve të kultivuara çdo vit, brenda muajit shkurt. Ndryshimet që bëhen gjatë vitit publikohen, periodikisht, nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve.”.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 509, datë 13.5.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 857, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
PARËSOR, NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 2 shkronja “b”, e 36 të ligjit nr. 7870, datë 13.4.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fjalja e dytë e pikës 7 të vendimit nr. 857, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Të ardhurat e krijuara nga shërbimet e ofruara sipas kësaj pike, përdoren tërësisht nga qendrat shëndetësore, si pjesë e kostos së shërbimit. Rregullat e veçanta për përdorimin e tyre



përcaktohen me udhëzim të këshillit administrativ të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 3.5.2012
Doli nga shtypi më 4.5.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 20 lekë